



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:251350

Datë: 02.08.2024

Numri i dokumentit: 06012483

Në çështjen juridike të : **AC-I-23-0068-A0001-A0002**

Paditësi/ankuesi

I L nga Prishtina , përfaqësuar nga av. B I nga Prishtina.

Kundër:

E paditura/Ankuesja

N.SH. "I.M.N Kosova" (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës dhe paditësit të paraqitura kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-22-0359, të datës 23 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 02 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet, Aktgjykimi i shkallës së parë i DHPGJS-së, C-IV-22-0359, i datës 23 janar 2023.**
- 3. Ankesa e paditësit konsiderohet e tërhequr.**
- 4. Nuk caktohen taksë gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 19 qershor 2015, paditësi në DHPGJS-së, ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Autoriteti i Likuidimit (AL) nr. PRN029-0089 të dt.25 maj 2015 me të cilin vendim ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej 3,665.00 euro për periudhën 07 qershor 2007 deri me 10 janar 2011, nga NSH "I.M.N. Kosova", për arsye të parashkrimit sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi ka kërkuar që të miratohet në tërësi kërkesa si e bazuar, të shfuqizohet vendimin PRN029-0089 i dt.25.05.2015 të AL-së, si dhe të obligohet e paditura që në emër të kompensimit të pagave të papaguara për 43 muaj në lartësi prej 85.00 euro për periudhën kohore 07 qershor 2007- 10 janar 2011, ti paguaj shumën e përgjithshme 3,665.00 euro, si dhe shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës në shumë prej 104.00 euro, si dhe të gjitha shpenzimet tjera deri në fund të procedurës.

Paditësi ka theksuar se tek e paditura ka themeluar marrëdhënie pune nga viti 2000, dhe se me 25.01.2011, 46 punëtorët kanë inicuar procedurë gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe se me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP dt.23 qershor 2014, ka filluar procedura e likuidimit të ndërmarrjes, dhe se me këtë rast të gjithë punëtorëve të kësaj ndërmarrje iu është ndërprerë marrëdhënia e punë nga AL-ja të NSH "I.M.N. Kosova". Më tej citon se e paditur nuk e ka kontestuar se paditësi ishte punëtor i kësaj ndërmarrje si dhe as lartësinë e kompensimit, por AL-ja në vendimin e ankimuar në mënyrë të gabuar, ka zbatuar të drejtën materiale në zbatim të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, e cila dispozitë, nuk paraqet ligj të aplikueshëm në Kosovë nga viti 1989, dhe se tani ankuesi i paraqet gjykatës bazat për një konstatim të tillë duke cituar dispozita ligjore për Ligjin 04/L-034 për AKP, Rregulloren e UNMIK2002/12, për Themelimin e AKM-së, Ligjin për Ndërmarrjet (GZ77/88) në fuqi nga dt.01.01.1989, Ligjin për Ndryshim plotësimi të Ligjit për Ndërmarrjet (GZ 40/89), Ligjin për Ndryshim plotësimi të Ligjit për Ndërmarrjet (GZ 46/90), dhe Ligjin për Ndryshim plotësimi të Ligjit për Ndërmarrjet (GZ 61/90), ndërsa lidhur me Propozimin për përmbarim të paraqitur nga ankuesi pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë me dt. 21.01.2011, AL-ja në vendimin e saj konstaton se propozimi për përmbarim nuk është miratuar, pasi që nuk ishte i bazuar në ndonjë vendim të prerë gjyqësor, duke konsideruar më tej se në këtë çështje juridike procedura përmbarimore është filluar në bazë të

dokumentit të besueshëm të përcaktuar sipas Ligjit për Procedurën Përmbartimore, që parqet momentin e ndërprerjes së parashkrimit. Padisë si prova, ia ka bashkangjitur: Vendimin e ALt, librezën e punës nr. regj.99907/96, propozimin për përmbartim E.nr 88/2011, dt.25.01.2011, regjistrin e 47 punëtorëve për propozim për përmbartim dhe vendimin për fillimin e likuidimit për NSH "I.M.N. Kosova" me seli në Prishtinë si dhe autorizim për përfaqësim nga avokati.

Me 15 shtator 2017, e paditura, AKP me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë ka parashtruar mbrojtjen e saj në ankesën e paraqitur nga pala paditëse ndër të tjera ka theksuar se me rastin e vendosjes, Autoriteti i Likuidimit (AL), ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme janë zbatuar saktë, se parashtruesi nuk ka cekur asnjë dispozitë ligjore që e ka shkelur Autoriteti i Likuidimi (AL) e në kuptim të nenit 70 par.2 të Shtojcë së Ligjit nr.04/L -033, ankesa është e pabazuar. Epaditura më tej thekson se parashtruesi pretendon për paga të pa paguara për periudhën prej dt.07.06.2007-10.01.2011, dhe si provë në pretendimet e tij ka dorëzuar propozimin për ekzekutim, E.nr.88/2011 dt.25.01.2011, për të cilën në momentin e dorëzimit të propozimit për ekzekutim në gjykatë pretendimet ishin parashkruar 3 (tre) vite nga dt.07.06.2007, dhe se këto pretendime nuk janë shqyrtuar për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit, andaj kërkesa është parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 dhe 37.4.1 të Ligjit, nr. 04/4-034 të AKP-së dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, në përfundim i propozoj gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL-së.

Me parashtresën përgjigje në mbrojtje të dt. 03 tetor 2017, paditesi ka kundërshtuar mbrojtjen e të paditurës, duke përsëritur qëndrimet e paraqitur në ankesë me kërkesë që gjykata të miratoj shumën për 43 paga në shumën e kërkuar 3,665.00 euro.

Me aktgjykimin C-IV-15-1116 të dt. 12.11.2021, Shkalle parë e DHPGJS e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, duke e lënë në fuqi vendimin, PRN029-0089 të lëshuar nga Autoriteti i Likuidimit e të cilin aktgjykim e ka ankimuar paditësi përmes të autorizuarit të tij dhe se me aktgjykimin, AC-I-21-0810, të dt. 17 nëntor 2022, Kolegji i Apelit i kësaj gjykate, e ka aprovuar ankesën, ka anuluar aktgjykimin e kësaj gjykate, C-IV-15-1116 dt. 12.11.2021 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim

dhe se lënda, pas ktherjes në rigjykim është evidentuar, C-IV - 22 – 0359, dhe janë ndërmarrë veprime plotësuese, për të cilën paditësi përmes të autorizuarit i është përgjigjur gjykatës me shkresën dt.20 dhjetor 2022, duke përsëritur qëndrimet e paraqitura në parashtresat paraprake.

Përgjigja e paditësit e i është dërguara te paditurës me 16 janar 2023, e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje.

Me 23 janar 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-22-0359 e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, të parashtruar kundër Vendimit, te AL nr.PRN029-0089 të dt.25 maj 2015 dhe e ka ndryshuar te njëjtin duke e obliguar të paditurën, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), t'ia kompensoj paditësit shumën e përgjithshme prej 255.00 € në emër të 3 (tri) pagave të papaguara, sipas prioritetit të kërkesave, si dhe kamatën ligjore në lartësi prej 10 %, në shumë prej 25.50 €. Ndërsa ka refuzuara pjesërisht si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, për pjesën që ka të bëjë me kompensimin e 40 (dy zetë) pagave të pa paguara respektivisht mbi shumën e aprovuar me këtë aktgjykim prej 255.00 € e deri në shumën e kërkuar prej 3,655.00 €. Po ashtu e ka obliguar të paditurën, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) - Autoritetin e Likuidimit që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet procedural dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 21.00 €, në emër të përpilimit të ankesës, shumën 21,00 €, si dhe në emër të shpenzimeve të përfaqësimit, shumën prej 104.00 € e në totalin e tyre prej 146.00 €.

Shkalla parë ka arsyetuar se pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve, pretendimeve të palëve në procedurë dhe duke marrë për bazë vërejtjet e bëra në aktvendimin e tij nga Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit, është pjesërisht e bazuar për një pjesë të saj kurse pjesërisht është e pabazuar për një pjesë të saj.

Tutje ka arsyetuar se ka konstatuar NSH "I.M.N Kosova" në Prishtinë, ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.23.06.2014 ndërsa parashtruesi ka parashtruar kërkesën tek AL-ja për kompensimin e pagave të papaguara me dt.08 korrik 2014 për periudhën 07.06.2007-11.01.2011, që është brenda afatit për parashtrimin e kërkesave në procedurë të likuidimit tek AL-ja. Po ashtu ka konstatuar se nuk ishte kontestuese se në mes të palëve ndërgjyqëse e ka qëndruar raportin juridik i

marrëdhënies së punës në mes të ankuesit dhe NSH "I.M.N. Kosova" me seli në Prishtinë të cilën tani e përfaqëson AKP, për të cilën kjo konstatohet me librezën e punës nr. regj.99907/96 të vulosur nga NSH "I.M.N Kosova" në Prishtinë, por kontestuese mbetet baza juridike e kërkesës të cilën e paditura e ka konsideruar si të parashkruar, të dhënë në vendimin, PRN029-0089 të AL-së. Lidhur e aprovimin e tre pagave të pa paguara e në shumë të përgjithshme prej 255.00 euro, Shkalla e parë bazohet në dispozitat nga neni 40.1.1.6.1 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP që në mënyrë taksative, citon se: *"Kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person"* dhe se këto kërkesa dhe interesa të kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 nga i njëjti nen 40, si dhe lidhur me kamatën ligjore u zbatua dispozita nga neni 37 par.3 të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, ku citohet se : *"Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore"*.

Më 06 shkurt 2023, përfaqësuesi i paditësit ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit të atakuar për shkak të të gjitha arsyeve ankimore, me të cilën ka propozuar që të miratohet në tersi ankesa si e bazuar të prishte aktgjykimi i atakuar dhe të kthehet në rigjykim duke e detyruar të paditurën që në emër të kompensimit për pagat e pa paguara për periudhën kohore prej datës 07 qershor 2007 deri më 10 janar 2011 paditësit t'ia paguajë shumën prej 3,655.00 euro duke përfshirë edhe kamatën ligjore si dhe shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve. Në ankesën e parashtruar ka theksuar se Objekt i shqyrtimit në këtë rast është Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN029-0089 i datës 25 maj 2015, siç shihet ky vendimi është nxjerrë lidhur me kërkesën kreditore në të cilën përfshihet kërkesës kreditore për pagat e pa paguara për periudhën qershor 2007 deri më 10 janar 2011. Tutje thekson faktin se gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka konstatuar faktin se lidhur me lartësinë e pagës mujore, paga mujore ka qenë në lartësinë prej 85 euro. Duke marrë për bazë lartësinë e pagës në shumë prej 85 euro atëherë për periudhën kohore 7 qershor 2007 deri më 10 janar 2011 (43 muaj) borxhi i përgjithshëm i të paditurës ndaj paditësit arrin shumën e përgjithshme prej 3,655.00 euro. Në rast të aplikimit të dispozitave që kanë të bëjnë me institutin e

parashkrimin atëherë pagat e pa paguara për periudhën kohore 25 janar 2008 deri më 10 janar 2011, nuk mund të jenë të parashkruara kjo për faktin se me datë 25 janar 2011, është bërë dorëzimi i propozimit për përmbartim E88/2011. Në këtë rast e paditura obligohet që paditësit për periudhën kohore 25 janar 2008 deri më 10 janar 2011, meqenëse lartësia e pagës minimale ka qenë 85 euro paditësit i takon kompensimi në lartësi të përgjithshme prej 3,060.00 euro (36 paga X 85 euro). Andaj siq shihet në rastin konkret është arritur të dokumentohet, faktohet provohet dhe të argumentohet qartë se ankesa e ankuesit duhet vepruar.

Me 13 shkurt 2023, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-22-0359 të datës 23 janar 2023. E paditura në ankese ka propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar duke e refuzuar ankesën ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit si të pa bazuar dhe vërtetuar Vendimin e Autoritetit të Likuidimit. E paditura në ankesën e parashtruar ka theksuar se duke u bazuar në Nenin 40.1.6.2 i shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 i jep të drejtë dëmshpërblimi vetëm atyre punëtorëve që janë pushuar nga puna si pasojë, e apo në lidhje me një veprim të ndërmarrë nga AKP-ja sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit nr. 04/L-034. Likuidimi është një veprim i paraparë me nenin 6.2 të Ligjit nr.04/L-034. Sipas nenit 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 rrjedhë se parashtruesi duhet të përmbushë dy kushtet e cekura aty për të përfituar të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, më konkretisht (1) punëtori duhet të jete pushuar nga puna dhe (2) ky pushim duhet të këtë ardhur si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP sipas nenit 6.1 apo 6.2 të ligjit nr.04//L-034. Tutje ka shtuar se për këtë arsye Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën për paga të pa paguara të kontratës së punës për parashtruesin pasi ky rezulton të mos ishte aktiv në momentin kur filloi likuidimi-ky i fundit i fundit një veprim i ndërmarrë nga AKP-ja sipas nenit 6.2 Rrjedhimisht duke qenë se nuk ishte në një marrëdhënie pune aktive me NSH-në, në momentin kur NSH-ja hyri në likuidim, nuk kishte se si marrëdhënia e tij e punës të ndërpritej nga një veprim nga Agjencia Kosovare e Privatizimit sipas nenit 6.1 apo 6.2 të ligjit nr.04/L-034.

Me 13 mars 2023, zyra e i financave të DHPGJS i ka lëshuar vërejtje paditësin/ankuesin, për pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar atë për pasojat

e mos përgjigjes. Padiësi vërejtjen për taksë e ka pranuar me 20 mars 2023, por ai nuk ka bërë pagesën e taksës gjyqësore.

Me 01 mars 2024, padiësi nëpërmjet përfaqësuesit ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i atakuar duke e detyruar të paditurën që në emër të kompensimit për pagat e pa paguara për periudhën kohore prej datës 07 qershor 2007 deri më 10 janar 2011 padiësit t'ia paguajë shumën prej 3,655.00 euro duke përfshirë edhe kamatën ligjore si dhe shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve.

Me 24 korrik 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një përgjigje në ankesën e padiësit. Më këtë përgjigje AKP-ja e kundërshton ankesën e padiësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj dhe ankesa e padiësit të refuzohet si e pabazuar. Tutje AKP-ja ka pohuar se në përgjigjet e saj të mëhershme ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa të paditurës është e pabazuar, ndërsa ankesa e padiësit konsiderohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se padiësi kishte parashtruar kërkesë tek AL më 08 korrik 2014, me të cilën ka kërkuar kompensimin për pagat e pa paguar në shumë prej 3,655.00 euro, për periudhën 07 qershor 2007 deri më 10 janar 2011 nga N.SH"

I.M.N Kosova" (Në likuidim). Kërkesa ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar.

Me 23 janar 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-22-0359 e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, të parashtruar kundër Vendimit, te AL nr.PRN029-0089 të dt.25 maj 2015 dhe e ka ndryshuar te njëjtin duke e obliguar të paditurën, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), t'ia kompensoj paditësit shumën e përgjithshme prej 255.00 € në emër të 3 (tri) pagave të papaguara, sipas prioritetit të kërkesave, si dhe kamatën ligjore në lartësi prej 10 %, në shumë prej 25.50 €. Ndërsa ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, për pjesën që ka të bëjë me kompensimin e 40 (dy zetë) pagave të pa paguara respektivisht mbi shumën e aprovuar me këtë aktgjykim prej 255.00 € e deri në shumën e kërkuar prej 3,655.00 €. Po ashtu e ka obliguar të paditurën, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) - Autoritetin e Likuidimit që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet procedural dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 21.00 €, në emër të përpilimit të ankesës, shumën 21,00 €, si dhe në emër të shpenzimeve të përfaqësimit, shumën prej 104.00 € e në totalin e tyre prej 146.00 €.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi dhe e paditura ka parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit.

Kolegji i Apelit në rastin konkret do të vlerësoj vetë përfundimet e të paditurës, dhe jo të paditësit, pasi që i njëjti nuk ka paguara taksën gjyqësorë për ankesë.

E paditura në ankesën e saj ka theksuar se duke u bazuar në Nenin 40.1.6.2 i shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 i jep të drejtë dëmshpërblimi vetëm atyre punëtorëve që janë pushuar nga puna si pasojë, e apo në lidhje me një veprim të ndërmarrë nga AKP-ja sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit nr. 04/L-034. Likuidimi është një veprim i paraparë me nenin 6.2 të Ligjit nr.04/L-034. Sipas nenit 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 rrjedhë se parashtruesi duhet të përmbushë dy kushtet e cekura aty për të përfutur të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, më konkretisht (1) punëtori duhet të jete pushuar nga puna dhe (2) ky pushim duhet të këtë ardhur si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP sipas nenit 6.1 apo 6.2 të ligjit nr.04//L-034.

Kolegji i Apelit vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument ligjor apo provë me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi.

Kolegji i Apelit vëren se me dt. 13 mars 2023, zyra e i financave të DHPGJS së Shkalles së II-të i ka lëshuar vërejtje paditësit/ankuesit, për pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar atë për pasojat e mos përgjigjes. Ankuesi vërejtjen për taksë e ka pranuar me 20 mars 2023, por ai nuk ka bërë pagesën e taksës gjyqësore dhe nuk ka paraqitur kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore.

Kolegji i Apelit vlerëson se konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së, paditësi ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar. Dispozita e nenit 253.5, parasheh: *"Në qoftëse se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr"*.

Paditësi ka për obligim ti paguajë taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 60 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr.01/2017, lidhur me taksat gjyqësore. Vërejtja ishte pranuar nga paditësi, më datë 20 mars 2023, mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri më vendosjen e këtij Aktgjykimi.

Kolegji i Apelit vëren se paditësit/ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të Kolegjit, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Prandaj nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës-AKP-së refuzohet si e pabazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj, ndërsa ankesa e paditësit konsiderohet e tërhequr.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja /Ankuesja tashmë e kanë paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro më datë 28 mars 2023 , andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 02 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
